

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 708 Prot.

Tiranë, më 22.052017

VENDIM Nr. 102, datë 17.05.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, datë 17.05.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Gërmimit Arkeologjik, në kuadër të *projektit të rehabilitimit "Sheshi publik para hyrjes së Portit të Durrësit"*, Bashkia Durrës, realizuar nga Instituti i Arkeologjisë dhe DRKK Durrës.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Gërmimit Arkeologjik, në kuadër të *projektit të rehabilitimit "Sheshi publik para hyrjes së Portit të Durrësit"*, Bashkia Durrës, realizuar nga Instituti i Arkeologjisë dhe DRKK Durrës sipas përcaktimeve të mëposhtme.
2. Pa cënuar Vendimin "Për Sigurimin e Padisë" Nr.(00176) 922 Rregj. Dt. 7.2.2017 Regjistrimi me Nr. (82-2017-152)-----Vendimi, Durrës 16.02.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Durrës, për strukturat e zbuluara:
 - Bastioni fortifikues i qytetit, ndërtim i shekullit XVII
 - Ngrahina e periudhës osmane të shekullit XIX, e ripërdorur si Konak i princ Vidit në vitin 1913
 - Pilastri romak në sondazhin Nr.3 (në afërsi të pallatit "FLAY")
 - Strukturat e zbuluara në sondazhin Nr. 4 (pranë bulevardit "Epidamn")


të shikohet mundësia e ruajtjes dhe integritimit me projektin e rehabilitimit "Sheshi publik para hyrjes së Portit të Durrësit", i cili do të kalojë për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKA.

3. Projekti me propozimet për ruajtje dhe integrim të stukturave të zbuluara, të kalojë për shqyrtim dhe vendimmarrje në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve dhe në vijim të vlerësohen nga ky Këshill në aspektin teknik arkitektonik dhe konstruktiv të formës së ekspozimit.



4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO-FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

